

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME DY ORTAK**  
**"MERCURY SERVICE" SHPK**

Sot me daten 01.04.2024 (dymijë e njëzet e katër), me ortakët themelues :

- **Znj. NELLI VLADIMIROVNA KARASEVA**, shtetase italiane, e datëlindjes 01.09.1977, lindur në Ekaterinburg, dhe banues në Venosa, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. Leternjoftimi/karte CA69589QV.
- **Z.Gofreddo Lovaglio**, shtetas italian, e datëlindjes 24.12.1969, lindur në Venosa, dhe banues në Venosa, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. Leternjoftimi/karte AZ0663604.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me dy ortakë* "MERCURY SERVICE" SHPK.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet "MERCURY SERVICE" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, **Lagjia nr 11, Rruga "Aleksander Goga", Zona kadastrale 8514, Godina me nr pasurie 1/279, Kati dyte. 2001 Durrës.**

**NENI 3**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e: Agjensi imobiliare, tregi artikujsh të ndryshëm, import dhe eksport, shërbime marketing dhe reklamimi, komisioner për ndërmjetësim të ndryshme tregtare, për lidhje kontratash, duke përfshirë çdo gjë që lejon legjislacioni shqiptar.

**KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë "MERCURY SERVICE" është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 2 kuota, me vlerë nominale 50.000 (njëqind mijë) lekë.



Kontributi i ortakeve eshte i ndare si vijon:

1. **Znj. NELLI VLADIMIROVNA KARASEVA** zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.
2. **Z. Gofreddo Lovaglio** zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.

#### **NENI 5**

#### **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

#### **NENI 6**

#### **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administratori i shoqërisë do të jetë **Znj. NELLI VLADIMIROVNA KARASEVA** e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### **NENI 7**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqërite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 8**

#### **NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

#### **Neni 9**

#### **LIKUJDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**

**MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

**ORTAKET THEMELUES TË SHOQËRISË  
"MERCURY SERVICE" SH.P.K**

**NELLI VLADIMIROVNA KARASEVA**

*Nelli Vladimirovna  
Karaseva*

**GOFREDDO LOVAGLIO**

*Goffredo Lovaglio*